



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 15 DHJETOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
15. DECEMBRA 2008. GODINE

DHJETOR – DECEMBAR
2008

R e n d i i d i t ë s:

1. Shqyrtimi i parë i Grupit të tetë të projektligjeve nga Propozimi i Marti Ahtisarit, sipas procedurës së veçantë:

- 1.1 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të huajt;
- 1.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi;
- 1.3 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- 1.4 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës;
- 1.5 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;
- 1.6 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës.

Dnevni red:

1. Prvo razmatranje Osme grupe nacarta zakona iz Predloga Martti Ahtisarija, po posebnom postupku:

- 1.1 Prvo razmatranje Nacrta zakona o strancima;
- 1.2 Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona o zdravstvu;
- 1.3 Prvo razmatranje Nacrta zakona o Ustavnom sudu Republike Kosovo;
- 1.4 Prvo razmatranje Nacrta zakona o privremenom sastavu Sudskog veæa Republike Kosovo;
- 1.5 Prvo razmatranje Nacrta zakona o Sluþbi spoljnih poslova Republike Kosovo;
- 1.6 Prvo razmatranje Nacrta zakona o Konzularnoj sluþbi diplomatskih i konzularnih misija Republike Kosovo.

Agenda:

1. First reading of the eight group of Draft laws from marti Ahtosaari's proposal, according to special procedure:

- 1.1 First reading of the Draft Law on Foreigners;
- 1.2 First reading of the Draft Law on Amendment and Supplementation of the Law on Health;
- 1.3 First reading of the Draft Law on Constitutional Court of Republic of Kosovo;
- 1.4 First reading of the Draft Law on Provisional Content of Legal Council of Republic of Kosovo;
- 1.5 First reading of the Draft Law on Foreign Service of Republic of Kosovo;
- 1.6 First reading of the Draft Law on Consular Service of Diplomatic and Consular Missions in Republic of Kosovo.

Seanca plenare filloi punën në orën 14,00.
Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 90 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

(Ndërprerje e shkurtër)

Në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të, sipas procedurës së veçantë, më 15 shkurt 2008, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2008, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Rendi i ditës, bashkë me materialet tjera, iu është shpërndarë deputetëve.
Për shkak të mungesës së ministrit, pikën e parë po e kalojmë dhe po vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

-Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi.

Ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi, që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës, para deputetëve, ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar, zoti zëvendëskryeministër, ministra dhe të çmuar deputetë,
Ju prezantoj Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi.

Amendimi i Ligjit për shëndetësi është bërë sipas Pakos së Ahtisarit, sipas të cilës komunat: Mitrovicë e veriut, Graçanicë dhe Shterpcë do të kenë kompetenca vetanake për ofrimin e kujdesit shëndetësor dytësor, duke përfshirë: regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor, punësimin, pagesën e pagave, aftësimin

profesional të personelit shëndetësor, në pajtueshmëri me udhëzimet dhe standardet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi. E gjithë kjo do të jetë në përputhshmëri të plotë me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Institucionet shëndetësore publike të nivelit dytësor do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë me institucionet shëndetësore të komunave tjera brenda sferës së kompetencave të veta në fushën e kujdesit dytësor shëndetësor, në pajtim me ligjet përkatëse.

Në amendamentin 3 të nenit 30, pikat 3 dhe 4, komunat Mitrovicë e veriut, Graçanicë dhe Shtërpçë do të vendosin për përmbushjen e kushteve për fillimin e punës së institucioneve shëndetësore të kujdesit dytësor në këto komuna.

Procedurën rreth përgatitjes së planeve strategjike, afatmesme dhe operative për të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor e siguron Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, pa paragjykuar kompetencat e komunave, sipas nenit 30 pika 3 të këtij ligji.

Në bazë të amendamentit 7, të nenit 72 – licencimin dhe akreditimin e institucioneve shëndetësore e bën Ministria e Shëndetësisë në bazë të rregullativës ligjore nga neni 40.3, pa paragjykuar kompetencat e komunave, sipas nenit 30 pika 3, duke përjashtuar në këtë rast akreditimin.

Po ashtu, edhe regjistrimi dhe licencimi i punëtorëve shëndetësor në nivel të vendit bëhet nga Ministria e Shëndetësisë, pa paragjykuar kompetencat sipas nenit 30 pika 3 të këtij ligji.

Procedurat rreth përgatitjes së planeve strategjike afatmesme dhe operative për të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor i siguron Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, pa paragjykuar kompetencat sipas nenit 30 pikë 3 të këtij ligji.

Konsiderojmë se me këto amendamente është reflektuar në tërësi kërkesa e paraparë ligjore me Pakon Gjithëpërfshirëse të Ahtisarit dhe është ruajtur uniteti i sistemit shëndetësor të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Radha është për shefat e grupeve parlamentare, por si duket ata janë pajtuar për këtë. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar po paraqes disa nga vërejtjet që i ka ky ligj, tashmë Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin, që kanë të bëjnë me amendamentin 7, konkretisht neni 72 me amendamentin 3, neni 30 pikë 3, që janë në kundërshtim me njëri-tjetrin. Në një vend në nenin 30 pikë 3 – komunat e bëjnë licencimin e institucioneve shëndetësore, ndërkaj në nenin 72 prapë thuhet “licencimin dhe akreditimin e institucioneve e bën Ministria e Shëndetësisë”. Kemi kundërshti të këtyre të dyjave, sikurse, po ashtu edhe e drejta që tashmë në disa pjesë të Kosovës, në disa komuna të vendoset për pagesën, për nivelin e pagave e tjera, e tjera – bie në kundërshtim dhe e dëmton zinxhirin e institucioneve në përgjithësi.

Në parim, i përkrahim këto ligje, edhe pse nuk po kanë fund tashmë ligjet që burojnë nga Pakoja e Ahtisarit. Ne kemi besuar se këto tashmë kanë marrë fund në pjesën e dytë të cilën e kemi pasur, por shihet se çdo herë po rritet ky numër i ligjeve dhe do të ishte mirë që si Kuvend ta dimë se sa është numri i ligjeve që burojnë nga Pakoja e Ahtisarit, cilat janë ato ligje dhe ku e kanë fundin, sepse kështu tashmë është krijuar një përshtypje që secili ligj që i vjen Kuvendit buron nga kjo pako.

Dhe, e fundit që dua ta them, është, po ashtu, që në nguti për ta kompletuar këtë infrastrukturë ligjore, ne po shohim më vonë se po kemi mospajtim të ligjeve në shumë fusha, qoftë me ligjet e tjera, qoftë me Kushtetutën dhe po detyrohemi që në një fazë tjetër kohore, prapë këto t'i harmonizojmë me Kushtetutën.

Unë besoj që Komisioni ad-hoc do t'i ketë parasysh këto vërejtje, në mënyrë që të mos kemi një dëmtim të zinxhirit të plotë të institucionit, në këtë rast të shëndetësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për sqarim, janë ligjet që derivojnë nga Pakoja gjithëpërfshirëse e Ahtisarit dhe mendoj se këtë duhet ta kuptojmë kështu qysh është. Fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Qasja, e cila po manifestohet sot dhe për të cilën po bisedojmë është një qasje segregative. Segregacioni nuk e ndihmon sistemin unik, do të thotë sistemin shëndetësor, për vetë faktin se nuk kemi të bëjmë këtu me një qasje të decentralizimit, por në fakt kemi të bëjmë me diskriminim ndaj një pjese tjetër. Ne kuptojmë se për bartje të përgjegjësi dhe për ngritje të sistemit dytësor shëndetësor ka nevojë Kosova për shumë pjesë, ka nevojë Kosova në shumë qendra, mirëpo një qasje e tillë ndaj vetëm një pjese, kujtojmë se është një qasje e cila nuk e ndihmon në tërësi sistemin shëndetësor. Duhet të kemi parasysh se ne kemi marrë disa obligime, por obligimet tona do të shtrihen në tërë territorin e Kosovës dhe këto obligime nuk përkojnë me nevojat që sistemi shëndetësor në Kosovë ta tejkalojë sfidën me të cilën po ballafaqohet aktualisht.

Kujtoj se krijimi i qarqeve të tilla dhe krijimi i qarqeve të mbyllura në disa pjesë të territorit të Kosovës, do të përcillet me pasoja në sistemin unik shëndetësor. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lulzim, ke qenë në proces në të gjitha vitet e kaluara, mendoj duhet ta kesh parasysh, s'je për herë të parë në Parlament. E di, domethënë, ke qenë në gjithë procesin e kaluar për bisedimet e Vjenës. Fjalën e ka kërkuar shefi i LDK-së, deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ministra të nderuar, zëvendëskryeministër,

Desha të them, këtë ju vetëm e paraqitët, kemi të bëjmë me një ligj që del nga Pakoja gjithëpërfshirëse e Presidentit Ahtisari, është marrëveshje ndërkombëtare e negociuar dhe Parlamenti e ka votuar, Parlamenti e ka votuar edhe procedurën miratimit. Ne në

Komisionin ad-hoc do të kemi mundësi ta shohim çka ka mundësi të adaptohet, por ajo që u paraqit këtu në emër të Qeverisë nga ministri Alush Gashi, është pjesë e përcaktuar.

Dua t'ua përkujtoj vetëm një çështje. Kemi të bëjmë me tri kompetenca vetanake, të veçuara për tri komuna të emëruara – që janë edhe ato, njëra prej tyre është e paragjykuar, sepse ende nuk është themeluar, por obligimin tonë ne e çojmë deri në fund.

Kjo është pjesë e angazhimeve tona dhe besoj se Komisioni ad-hoc do të arrijë sonte ta përfundojë punën, në mënyrë që nesër të kalojë.

Grupi ynë parlamentar e mbështet, në parim, në lexim të parë këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit! Pasi që çdo grup parlamentar ka anëtarin e vet në Komisionin ad-hoc, vërejtjet mund të shkojnë në Komisionin ad-hoc. Nuk kemi diskutues tjerë. Vazhdojmë me procedurën e votimit. Pra, e votojmë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi.

Lus regjinë të përgatitet për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 17 “kundër” dhe 17 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi.

Faleminderit! Kalojmë në pikën e radhës.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj ministrin e Shërbimeve Publike, zotin Arsim Bajrami, që në emër të Qeverisë, para deputetëve, ta paraqesë Projektligjin.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Para jush po paraqes Projektligjin për Gjykatën Kushtetuese, padyshim një projektligj organik, një ligj shumë i rëndësishëm, i cili po i hap rrugën themelimit të një institucioni shumë të rëndësishëm kushtetues, siç është Gjykata Kushtetuese.

Themelimi i Gjykatës Kushtetuese paraqet një moment të rëndësishëm, sepse po e përmbyll ciklin e shtetndërtimit dhe po e themelon një institucion shumë të rëndësishëm dhe të specializuar për mbrojtjen dhe interpretimin e Kushtetutës.

Padyshim se Kushtetuta e Republikës së Kosovës me kohë ka paraparë që Kosova të hyjë në radhën e shteteve evropiane që i takojnë sistemit të gjyqësisë kushtetuese, sepse jo të gjitha vendet kanë një sistem të mbrojtjes të kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë

përmes Gjykatës Kushtetuese, dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka referuar, që me një ligj të veçantë do të përcaktohen çështjet tjera organizative me rëndësi për themelimin e Gjykatës Kushtetuese.

Unë dëshiroj, paraprakisht, t'i falënderoj të gjitha grupet parlamentare që kanë qenë pjesë e hartimit të këtij ligji. Në hartimin e këtij ligji është shfrytëzuar me kohë dhe ekspertiza shumë e lartë ndërkombëtare. Ne e kemi zhvilluar një proces të gjatë të draftimit të këtij ligji, ku kemi kyçur shumë ekspertë ndërkombëtarë, përfaqësues të gjykatave kushtetuese me renome dhe, me rastin e zgjedhjes së modelit, ne jemi orientuar për modelin evropian kontinental, modelin gjerman dhe austriak, ku edhe është vendlindja e gjyqësisë kushtetuese.

Me miratimin e këtij ligji, i cili po procedohet me të drejtë në bazë të mocionit të Pakos së Ahtisarit, sepse Pakoja e Ahtisarit flet për Gjykatën Kushtetuese dhe ka provizionet e veçanta, të cilat janë me rëndësi për këtë pako, po i hapet rruga themelimit të kësaj gjykate dhe, siç e dini, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë edhe masa tjera që Kosova sa më shpejt të bëhet me Gjykatën Kushtetuese, ndërkohë Ministria e Shërbimeve Publike është duke përgatitur objektin e përkohshëm për këtë gjykatë.

Qeveria e Kosovës, në propozimin e Buxhetit ka ndarë mjete për vitin 2009, dhe thjesht janë plotësuar të gjitha kushtet që Kosova në fillim të vitit 2009 ta ketë Gjykatën Kushtetuese.

Me themelimin e këtij institucioni, ne deklarimet tona politike për sundimin e ligjit po i bëjmë përkushtime konkrete, sepse po e themelojmë një institucion, i cili do të jetë instanca e fundit e respektit për Kushtetutën dhe ligjin dhe, me këtë ne po rreshtohemi në radhën e demokracive kushtetuese, të shoqërive evropiane ku respekti për Kushtetutën është vlerë fundamentale e një shoqërie.

Gjykata Kushtetuese në fakt, siç e dini, do të ketë një kompozicion të përzier, sepse në mandatin e parë fillestar këtu do të kemi edhe tre gjyqtarë ndërkombëtarë. Meqenëse unë e kam kryesuar grupin i cili e ka përgatitur themelimin e këtij organi, kemi marrë informacion që është në përfundim procedura ndërkombëtare rreth zgjedhjes së tre gjyqtarëve ndërkombëtarë. Pra, shpresojmë edhe në mirëkuptimin e Kuvendit të Kosovës, që në fillim të vitit 2009, edhe ne të përshpejtojmë dhe sa më shpejt ta themelojmë këtë organ, sepse nevoja e kontrollit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë është imediate, duke qenë se deri më tani ky funksion nuk është ushtruar nga Gjykata Supreme ku ka ekzistuar një kolegji për Kornizën Kushtetuese, i cili asnjëherë nuk ka qenë funksional.

Thjesht, me themelimin e këtij organi, do të fillojë një kontroll i kualitetit të ligjeve, të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të tri pushtetet do të jenë të obliguara që në fakt të veprojnë në procedura plotësisht ligjore dhe kushtetuese.

Ligji është hartuar me standarde mjaft të larta, me një gjuhë kushtetuese, sepse për nga natyra ligji është i karakterit kushtetues.

T'ju përkujtoj se përpos këtij ligji, pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese do të ketë edhe një rregullore të punës së brendshme të Gjykatës, me të cilën do të rregullohen çështjet procedurale. Vetë Kushtetua ka referuar që çështjet e procedurave para gjykatave kushtetuese të rregullohen me Rregulloren e Punës së Gjykatës, e cila do të miratohet nga Kolegjiumi i gjykatësve, pasi që Gjykata Kushtetuese të jetë funksionale.

Duke kërkuar që ta mbështetni këtë ligj, ne do t'i përcjellim edhe rekomandimet e Komisionit ad-hoc dhe do të japim mendimin rreth atyre propozimeve, nesër, posa t'i kemi në dorë.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Të lajmëruar për fjalë nuk kemi. A ka ndokush nga shefat e grupeve që dëshiron fjalën? Jo! Atëherë, lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë, tash:

Konstatoj se me 77 vota “për”, 4 “kundër”, 6 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t'i paraqesë Kuvendit Raportin me rekomandime.

Vazhdojmë pikën e radhës.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të huajt

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008 janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti, që në emër të Qeverisë të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë

Më lejoni që shkurtimisht të prezantoj para jush Projektligjin për të huajt, i cili është iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Siç e dini, nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e rëndësishë të madhe, ngase kemi të bëjmë me një ligj, me një fushë që deri më tash është rregulluar me një rregullore të UNMIK-ut, pra me Rregulloren 2005/16, dhe është i një rëndësie po aq të madhe, sidomos pas shpalljes së pavarësisë, ku është nevojë imediate që institucionet tona ta rregullojnë këtë fushë në përputhje me legjislacionin tonë.

Qëllimi i këtij projektligji është që në mënyrë unike të vendosë rregulla ligjore për hyrjen, lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve në Kosovë. Ky projektligj i adreson të gjitha këto çështje që kanë të bëjnë me hyrjen, lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve, pajisjen me letërnjoftim, si dhe me dokumentet e udhëtimit për të huaj.

Projektligji është i bazuar në modele më të avancuara që e rregullojnë këtë fushë dhe është në harmoni me normat dhe standardet më të larta të BE-së.

Projektligji e krijon një stabilitet legjislativ në këtë fushë dhe, për zbatimin e tij, po ashtu, janë të planifikuara edhe mjete buxhetore. Sipas rregullave, ky projektligj e ka marrë edhe një pajtueshmëri edhe nga Agjencia për Integritet Evropian dhe është i përgatitur në gjuhët zyrtare.

Duke i falënderuar të gjithë ata që kanë punuar në përgatitjen e këtij projektligji, kërkoj nga ju që ta miratoni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Të lajmëruar nuk kemi për diskutim. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, 4 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për të huajt.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t’i paraqesë Kuvendit Raportin me rekomandime.

Pika e katërt e rendit të ditës:

**-Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përbërjen e
përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së
Kosovës**

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari zoti Kryetar i Parlamentit,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë ministra,
Të respektuar deputetë,

Sot para nesh kemi Projektligjin për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Ky projektligj është i bazuar në nenin 151 për dispozitat kalimtare të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, faqe 62.

Deri me tash, përbërja e Këshillit Gjyqësor Prokurorial ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2005/52. Me këtë ligj tani rregullohet procesi i emërimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në përputhje me nenin 151 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Këshilli Gjyqësor është institucion i pavarur, i cili i ka të përcaktuara kompetencat. Pikërisht me këtë ligj, përgjegjësitë e Këshillit janë që të bëjë: kryerjen e inspektimeve gjyqësore, administrimin gjyqësor, hartimin e rregullave të gjykatave në pajtim me Ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, përgatitjen dhe mbikëqyrjen e buxhetit gjyqësor, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion dhe dhënien e rekomandimeve për themelimin e gjykatave të reja.

Përgjegjësi e Këshillit është edhe rekomandimi për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Ky ligj ka gjithsej 3 kapituj. Kapitulli i parë ka tri nene. Me këtë kapitull rregullohen qëllimi i ligjit, statusi i Këshillit, përgjegjësitë e Këshillit.

Kapitulli i dytë ka shtatë nene dhe rregullon çështjen e anëtarëve të Këshillit, përbërjen e Këshillit gjatë procesit të emërimit: kuorumin dhe votimin, mandatin e anëtarëve të Këshillit, kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin e Këshillit, emërimin e anëtarëve të Këshillit.

Kurse, kapitulli i tretë ka të bëjë me dispozitat kalimtare dhe hyrjen në fuqi të këtij projektligji.

Do t'ju them se ky projektligj është i karakterit të përkohshëm, sepse sipas Pakos së Ahtisarit duhet të bëhet riemërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve aktual, por edhe i atyre që konkurrojnë për emërim për institucionet e drejtësisë, kurse në përgatitje e sipër është Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës, të cilat së bashku me Ligjin për gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e shtetit përbëjnë pakon e ligjeve me të cilat do të fillojë edhe reforma gjyqësore.

Mirëpo, ky ligj, meqë është i natyrës së përkohshme dhe derivon nga dispozitat kalimtare të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bie në të ashtuquajtura ligje të Pakos së Ahtisarit dhe miratohet në procedura të veçanta në Parlament.

Ju lus që ta miratoni në lexim të parë këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministre!

A do dikush fjalën nga shefat e grupeve parlamentare? Jo! Faleminderit!

Lus regjinë të përgatitet për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 75 vota “për”, 5 “kundër” dhe 9 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj ministrin, zotin Skënder Hyseni, që në emër të Qeverisë të Republikës, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Kam nderin që sot para jush të paraqes Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, të sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Ky projektligj rregullon dhe organizon veprimtaritë kryesore të Shërbimit të Jashtëm të Republikës, duke përfshirë këtu të gjitha ambasadat që aktualisht janë funksionale, si dhe ato që së shpejti do të hapen në shtetet e ndryshme të botës, sipas prioriteteve dhe nevojave për përfaqësim të Republikës.

Miratimi i këtij projektligji do të përcaktonte shërbimin e jashtëm si përgjegjësi të veçantë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe me këtë do të mundësojë organizimin dhe realizimin e të gjitha aktiviteteve kryesore diplomatike dhe konsullore në kuadër të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj është hartuar në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare, me Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike të 18 prillit 1961, si dhe me atë për Marrëdhëniet Konsullore, të 14 prillit 1963.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj që ta miratoni në parim këtë projektligj, i cili saktëson përgjegjësitë e organeve të Shërbimit të Jashtëm, përcakton po ashtu marrëdhëniet mes tyre, në njërën anë, dhe marrëdhëniet mes këtyre institucioneve dhe institucioneve tjera të Republikës, në anën tjetër. Me një fjalë, ky projektligj krijon parakushtet e nevojshme për përfaqësim efikas dhe promovim të suksesshëm të interesave të Republikës dhe të shtetasve të saj jashtë vendit.

Unë edhe njëherë ju ftoj që ta miratoni, në parim, këtë projektligj. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Të lajmëruar për diskutim nuk ka, as nga grupet parlamentare. Fillojmë procedimin e votimit.

Lus regjinë të përgatitet për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 78 vota “për”, 3 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Pika e radhës.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplommatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj ministrin Skënder Hyseni, që në emër të Qeverisë, para deputetëve, ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Faleminderit, sërish zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Njësoj si edhe ligji paraprak për fushën e vet, edhe ky ligj rregullon fushëveprimtarinë e Shërbimit Konsullor dhe ushtrimin në mënyrë më të efektshme dhe të suksesshme të veprimtarisë së tij, të këtij shërbimi tepër të rëndësishme për mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të Republikës së Kosovës dhe të shtetasve të saj jashtë vendit.

Gjithashtu, edhe ky projektligj është hartuar në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare përkatëse, si dhe me konventat përkatëse ndërkombëtare: Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Diplommatike, të 18 prillit 1961, si dhe Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Konsullore, të 14 prillit 1963.

Konsiderojmë se rregullimi i kësaj fushe me legjislacion është në dobi të vendit, sepse do të ofronte shërbime konkrete për shtetet pranuese, si dhe për shtetasit tanë në vendet përkatëse.

Përmes këtij projektligji bëhet edhe forcimi i lidhjeve ndërmjet diasporës kosovare dhe autoriteteve të Republikë, domethënë këto lidhje tani do të përcaktoheshin edhe në bazë përkatëse ligjore.

Përderisa koha kalon, Shërbimi Konsullor mbetet jofunksional, pa kornizën e duhur ligjore, prandaj unë ju ftoj që ta miratoni këtë projektligj në parim, me qëllim të rregullimit të kësaj fushëveprimtarie me interes të veçantë për shtetin dhe qytetarët e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Të lajmëruar për diskutim nga shefat e grupeve parlamentare nuk ka. Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim, në parim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 82 vota “për”, 2 “kundër” dhe 4 abstencione, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të 15 shkurtit 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës Kuvendit t’i paraqesë raportin me rekomandime.

Atëherë, zotërinj deputetë, me kaq seancën e deklaroj të mbyllur.

Seanca tjetër do të mbahet më 16 .12. 2008, në orën 14:00.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve